



BASHKIA GJIROKASTËR
DREJTORIA E URBANISTIKËS

RELACIONI TEKNIK

**OBJEKTI: “Riveshje asfaltike e rrugëve Koco Kocollari,
Harillaq Liti dhe Doktor Vasil Laboviti”.**

PROJEKT ZBATIMI

Hartoi:

Ing. Aleksandri Pesha K.0797/2

Ing. Farold Mene K.3638

KORRIK 2026

PËRMBAJTJA

KAPITULLI 1	TË PËRGJITHSHME.....	3
KAPITULLI 2	PROBLEMATIKAT.....	3
	<i>KAPITULLI 2.1 FOTOGRAFI TË GJENDJES EKZISTUESE.....</i>	<i>3</i>
KAPITULLI 3	TE DHËNA DHE KËRKESA TË PROJEKTIT.....	7
KAPITULLI 4	NDËRHRYJET E PROPOZUARA.....	8

1. TË PËRGJITHSHME

Bashkia Gjirokastrë në vijim të investimeve për përmirësimin e cilesisë së jetesës së banorëve, parashikon riveshjen asfaltike të rrugëve Koco Kocollari, Harillaq Liti dhe Doktor Vasil Laboviti.”, Njwsia Administrative Gjirokastrë, Bashkia Gjirokastrë.

Bazuar në kushtet teknike të projektimit për objektin: “Riveshje asfaltike e rrugëve Koco Kocollari, Harillaq Liti dhe Doktor Vasil Laboviti.”, grupi i projektimit të Bashkisë Gjirokastrë ka propozuar një projekt i cili ofron një zgjidhje funksionale dhe arkitektonike në përputhje me KTP dhe KTZ. Qëllimi i projektit konsiston në përmirësimin e mjedisit urban, krijimin e hapësirave më miqësore për funksionimin e kësaj rruge si infrastrukture e mirëfilltë bashkëkohore dhe kthimin e saj në shërbim të komunitetit, duke qënë se është një rrugë qendrore me impakt të drejtpërdrejtë për banorët e kësaj zone . Sistemimi i kësaj rruge do të bëjë të mundur lehtësimin e qarkullimit të banorëve të zones

VENDNDODHJA:




Fig.1 Horografia e objektit

2. PROBLEMATIKAT

Nga verifikimet në terren rezulton se rrugët “**Koço Kocollari**”, “**Harillaq Liti**” dhe “**Dr. Vasil Laboviti**”, në Njësinë Administrative Gjirokastrë, paraqesin amortizim të konsiderueshëm të shtresës asfaltike ekzistuese si pasojë e konsumimit nga trafiku, veprimet të agjentëve atmosferikë dhe ndërhyrjeve të mëparshme në trupin e rrugës.

Gjatë inspektimit në terren janë konstatuar këto problematika kryesore:

- konsumim i shtresës së konsumit dhe humbje e karakteristikave funksionale të asfaltit;
- çarje gjatësore dhe tërthore në sipërfaqen e karrexhatës;
- zona me riparime të pjesshme dhe mbivendosje të ndryshme të asfaltit, të cilat kanë krijuar pabarazi në profilin e rrugës;
- deformime dhe gropa të lokalizuara, kryesisht në afërsi të kryqëzimeve, hyrje-daljeve të objekteve dhe elementëve të rrjetit të kullimit;
- sipërfaqe me ashpërsi të lartë dhe humbje të homogjenitetit të shtresës asfaltike.

Megjithëse struktura mbajtëse e rrugëve nuk paraqet dëmtime që kërkojnë rikonstruksion të plotë, gjendja aktuale e shtresës së konsumit nuk garanton më parametrat e nevojshëm të komoditetit, sigurisë dhe jetëgjatësisë së infrastrukturës rrugore.

Me poshtë paraqesim disa foto nga gjendja ekzistuese të rrugëve.

1.1 FOTOGRAFI TË GJENDJES EKZISTUESE:

A. RRUGA “DR. VASIL LABOVITI”



Figura 2. Pamje e përgjithshme e karrexhatës në segmentin kryesor të rrugës “Dr. Vasil Laboviti”.



Figura 3. Pamje e karrexhatës me degradime dhe ndërhyrje të mëparshme në rrugën “Dr. Vasil Laboviti”.



Figura 4. Gjendja ekzistuese në zonë kryqëzimi dhe lidhjeje me rrugë dytësore.



Figura 5. Gjendja ekzistuese në zonë kryqëzimi dhe lidhjeje me rrugë dytësore.



Figura 6. konstatohet një shtresë asfaltbetoni me konsumim të përgjithshëm sipërfaqësor.

B. RRUGA “HARILLAQ LITI”




Figura 7, Gjendja e shtresës asfaltike Rruga Harillaq Liti



Figura 8, Gjendja e shtresës asfaltike Rruga Harillaq Liti



Figura 9, Gjendja e shtresës asfaltike Rruga Harillaq Liti



Figura 10 , Gjendja e shtresës asfaltike Rruga Harillaq Liti



Figura 11, Gjendja e shtresës asfaltike Rruga Harillaq Liti



Figura 12, Gjendja e shtresës asfaltike Rruga Harillaq Liti

C. RRUGA KOCO KOCOLLARI:



Figura 13, Gjendja e shtresës asfaltike Rruga Koco Kocollari



Figura 14, Gjendja e shtresës asfaltike Rruga Koco Kocollari



Figura 15, Gjendja e shtresës asfaltike Rruga Koco Kocollari


3. TË DHËNA DHE KËRKESA TË PROJEKTIT

Objekti i këtij projekti konsiston në rehabilitimin e infrastrukturës rrugore urbane nëpërmjet realizimit të riveshjes asfaltike të rrugëve “Koço Koçollari”, “Harillaq Liti” dhe “Dr. Vasil Laboviti”, të ndodhura në Njësinë Administrative Gjirokastrë, Bashkia Gjirokastrë. Ndërhyrja është projektuar me qëllim rikthimin e parametrave teknikë dhe funksionalë të shtresës rrugore, përmirësimin e kushteve të qarkullimit të automjeteve dhe këmbësorëve, rritjen e sigurisë rrugore, si dhe zgjatjen e jetëgjatësisë së infrastrukturës ekzistuese, nëpërmjet rehabilitimit të shtresës së konsumit dhe eliminimit të dëmtimeve të evidentuara gjatë verifikimeve në terren.

4. NDËRHYRJET E PROPOZUARA

Në kuadër të projektit janë parashikuar këto ndërhyrje kryesore:

- skarifikim i plotë i sipërfaqes ekzistuese të karrexhatës;
- spërkatja e sipërfaqes me emulsion bituminoz për sigurimin e lidhjes ndërmjet shtresave;
- shtrimi dhe ngjeshja e shtresës së re të asfaltobetonit me trashësi **4 cm**, sipas preventivit dhe specifikimeve teknike;






Fig.17 Rikonstruksioni i rruges

Punimet e skarifikimit, spërkatjes me emulsion bituminoz dhe shtrimit të shtresës së re të asfaltobetonit do të realizohen në të gjithë gjerësinë ekzistuese të karrexhatës, e cila **VARION NGA 4.00 M DERI NË 8.00 M**. Kalimet ndërmjet segmenteve me gjerësi të ndryshme do të trajtohen në mënyrë të vazhduar, duke garantuar një profil të rregullt, lidhje të njëtrajtshme të shtresës së re dhe kullim normal të ujërave sipërfaqësore.



Fig.18 Planimetria e pergjithshme